



REPUBLIKA E SHQIPĒRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME**

**NJOFTIM PËR VEND PUNE**

**SHPALLJE PER PLOTESIMIN E VENDEVE TE LIRA PER KATEGORINE E ULET  
DREJTUESE**

**Për të dyja procedurat (lëvizje paralele/ngritje në detyrë) aplikohet në të njëjtën kohë!**

*Pozicioni i më sipërm u ofrohet nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se këto pozicione janë ende vakant, ato janë të vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.*

**I. LËVIZJE PARALELE BREnda SË NJËJTËS KATEGORI**

Shpallje për lëvizjen paralele brënda së njejtes kategori për plotësimin e vëndit të lirë të punës në AKEP.

1. Në zbatim të Kreut V të Ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si dhe Kreut II të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) shpall procedurat e lëvizjes paralele brënda së njejtës kategori, për pozicionin:

**“Inspektor i Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”**

**Drejtoria e monitorimit, kontrollit dhe inspektive**

Kategoria e pagës III-a

2. Përshkrimi i përgjithshëm i punës (detyrat kryesore) për këtë pozicion janë:

**- MISIONI :**

Siguron mbështetje për zbatimin me profesionalizëm dhe përgjegjësi të detyrave funksionale të njësisë organizative lidhur me kontrollin dhe inspektimin e veprimtarisë së subjekteve që

ushtrojnë aktivitet/e të autorizuar nga AKEP sipas legjislacionit material të fushës së komunikimeve elektronike.

- **QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I POZICIONIT TË PUNËS:**

Inspektori i Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike përgjigjet përpara Përgjegjësit të Sektorit të Kontrollit dhe Inspektimit për zbatimin me profesionalizëm dhe përgjegjësi të detyrave funksionale lidhur me kontrollin dhe inspektimin e veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet/e të autorizuar nga AKEP sipas legjislacionit material të fushës së komunikimeve elektronike, me qëllimi përm bushjen e misionit të drejtorisë, objektivave si dhe detyrimeve ligjore dhe rregullatore.

- **DETYRAT KRYESORE**

Inspektori i Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike, siguron që:

1. T'i jepet mbështetje eprorit direkt për administrimin dhe mbarëvajtjen e procesit të kontrollit dhe inspektimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet/e të autorizuar nga AKEP mbi bazën e legjislacionit material të fushës së komunikimeve elektronike, sipas metodologjisë dhe akteve rregullatore të nxjerra nga AKEP për këtë qëllim.
2. Të japi mbështetje për kryerjen e analizave të riskut dhe zbatimin e rekomandimeve si dhe masave administrative të vendosura për subjektet e kontrolluara dhe inspektuara.
3. Të japi mbështetje që raportimi dhe dhënia e informacionit periodik dhe të vazhdueshëm për punën dhe përm bushjen e detyrave në kuadër të veprimtarisë së njësisë organizative, të kryhet në afat dhe sipas procedurës së përcaktuar në aktet e nxjerra nga Titullari për këtë qëllim.
4. Të japi mbështetje dhe sigurojë që rekomandimet dhe masat e vendosura për shkeljet dhe kundërvajtjet administrative të provuara, të jalin rezultate të matshme në drejtim të disiplinimit të ushtrimit të veprimtarisë nga subjektet e autorizuara, në përputhje me legjislacionin dhe kuadrin rregulator në fuqi, në mënyrë të veçantë në mbrojtjen dhe garantimin e zbatimit të të drejtave ligjore të përdoruesve.
5. Ti japi mbështetje eprorit direkt që bashkëpunimi me Inspektoriatin Qendror dhe organet e tjera ligjzbatusse të fushës, të jetë i përhershëm, i vazhdueshëm dhe në konformitet me ligjin.
6. Bashkepunon ngushtesisht me Sektoret Rajonale te Monitorimit dhe Inspektimit, per shkembinin e informacionit dhe perpunimin e tij.

7. Inspekton sipermarresit/subjektet bazuar ne planin e veprimit dhe dokumentave rregullatore ne fuqi;
8. Pergatit aktet e inspektimit dhe ndjek ne vashdimesi zbatimin e rekomandimeve/ propozimeve te shoqeruara me afate, per rregullimin e shkeljes/ve se konstatuar nga grupi i inspektimit.
9. Pergatit procedurat per zbatimine e detyrave per te cilat eshte marre vendim nga instanca perkatese, ben komente dhe jep rekomandime per ate pjese te korespondences se AKEP qe i delegohet dhe ka te beje me inspektimin.
10. Organizon dhe zbaton me drejtorite e institucionit, kryerjen e veprimtarise se inspektimit te planifikuar apo rastesor;
11. Zbaton procedurat administrative dhe organizative per planifikimin dhe kryerjen e inspektimeve ne sektorin e komunikimeve elektronike;
12. Propozon dhe percatit planet e inspektimit
13. Bashkepunon ngushtesisht me Zyrat Rajonale te Monitorimit dhe Inspektimit, per shkembinin e informacionit dhe perpunimin e tij.
14. Inspekton sipermarresit/subjektet e komunikimeve elektronike, bazuar ne planin e veprimit dhe dokumentave rregullatore ne fuqi;
15. Pergatit aktet e inspektimit dhe ndjek ne vashdimesi zbatimin e rekomandimeve/ propozimeve te shoqeruara me afate, per rregullimin e shkeljes/ve se konstatuar nga grupi i inspektimit.
16. Mer pjese ne procesin e bllokimit te pajisjeve kur identifikohen subjekte te cilat zhvillojne veprimtari ne fushen e komunikimeve elektronike, te paautorizuar nga AKEP
17. Mer pjese ne procesin e inspektimeve ne sektorin postar dhe regjistrareve te domain.al kur i kerkohet.
18. Pergatit procedurat per zbatimine e detyrave per te cilat eshte marre vendim nga instanca perkatese, ben komente dhe jep rekomandime per ate pjese te korespondences se AKEP qe i delegohet dhe ka te beje me inspektimin.

### 3. Kërkesat e vecanta per këte vend pune janë :

**Arsimi :** Të zotëroje diplomë “Master Shkencor” ne Shkencat e Inxhinierise Elektronike, Shkencat e Telekomunikacionit/ Shkencat Juridike.

**Përvoja :** Të ketë eksperiencë profesionale në fushën e komunikimeve elektronike, telekomunikacionit, juridike dhe administrative.

**Të tjera :** Të detyrueshme,

- Njohuri të mira në fushën e komunikimeve elektronike.
- Njohuri shumë të mira praktike në përdorimin e kompjuterit dhe të programeve aplikative të administrimit të të dhënavës dhe aftësi për të përpunuar të dhëna teknike.
- Njohja e gjuhës angleze e çertifikuar në nivel profesional. Çdo gjuhë e huaj tjetër përbën avantazh.
- Aftësi analitike dhe krijuese për zgjidhjen e situatave komplekse.
- Njohuri dhe interes i vazhdueshëm për të qenë në korrent të parimeve dhe praktikave më të mira për kontrollin dhe inspektimin në vendet e BE dhe më gjerë.
- Njohuri dhe interes i vazhdueshëm për të qenë i informuar vazhdimisht me vendimet e nxjera nga Këshilli Drejtues, organizatat ndërkombëtare të fushës ku Republika e Shqipërisë/AKEP aderon të cilët janë gjithnjë orientues në punë.
- Aftësi vet-motivuese për të punuar i pavaruar brenda afateve kohore të ngushta në një mjesid pune intensiv, me qëllim përgatitjen e dokumenteve rregullatore.
- Aftësi vet-organizuese, dhe aftësi krijuese për të dhënë sugjerime dhe propozime të dobishme për ecurinë e punës.
- Aftësi shumë të mira për të relatuar me shkrim dhe me gojë në nivelet më të larta drejtuese.
- Të ketë cilësitë e nevojëshme për të punuar në grup.

**4. Kushtet minimale që duhet të plotësojnë kandidatët për këtë procedure, janë:**

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilen aplikon;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë, të paktën, vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;
- ç- Të plotësojë kushtet dhe kërkesat e posacme të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

**5. Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e Protokollit të AKEP, dokumentet e dosjes së tij personale:**

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
- Jetëshkrimi CV (mund të hartohet në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhëzime-dokumenta/219-udhëzime-dokumenta>)
- Nje numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID) ose Pashaportës.
- Fotokopje të diplomave.
- Fotokopje të listës se notave.
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vertetojnë eksperiencën në punë).

- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.
- Aktin e emëritit si nëpunës civil.
- Vërtetimin nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi
- Vertetimin e gjendjes shëndetësore.
- Vertetimin e gjendjes gjyqësore.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.
- Formulari i vetëdeklarimit për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike sipas linkut <http://www.dap.gov.al/legislacioni/udhezime-manuale/104-formularin-i-vetedeklarimit-per-garantimin-e-integritetit-te-personave-qe-zgjidhen-emerohen-ose-ushtrojne-funksione-publike->

6. Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në zyrën e Protokollit, të Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), Rr. Reshit Collaku, brenda datës **17.05.2018**.
7. **Rezultatet për verifikimin paraprak** të kushteve minimale të procedurës lëvizje paralele brënda së njejtës kategori dhe të përbushjes së kriterieve specifike të vendit të punës do të dalin në datë **18.05.2018** nëpërmjet shpalljes së listës emërore të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”dhe në faqen zyrtare të Institucionit të AKEP. Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse, brenda 3 ditëve pune nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve pune nga data e depozitimit të saj.
8. **Konkurimi -Intervista me gojë** do të zhvillohet në ambientet e AKEP (salla e mbledhjeve), Rr.Reshit Collaku, në datën **28.05.2018** ora **11:00**.

#### 9. Fusha kryesore mbi të cilën bazohet konkuri:

- Kushtetuta e Republikës se Shqiperise;
- Kodi i Punes
- Kodi i Procedurave Administrative
- Kodi Civil
- Ligjin nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”i ndryshuar dhe akteve nënligjore të tij;
- Ligjin nr.9131, datë 08.09.2003 “*Për rregullat e etikës në administratën publike*”;
- Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014, “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, i ndryshuar.
- Ligjin 119/2014 “*Për të drejten e informimit*”
- Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*” i ndryshuar

- Ligjin Nr. 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publike" i ndryshuar
- Ligjin nr. 9918, datë 19.08.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, (<http://www.akep.al/legislacioni/ligje>)
- Ligjin Nr. 46/2015 "Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë" (<http://www.akep.al/legislacioni/ligje>)
- RREGULLORE  
<https://akep.al/legislacioni/rregullore>  
<https://akep.al/sherbim-postar/rregullore>
- <http://www.akep.al/legislacioni> (Ligj, VKM, Rregullore, në faqen zyrtare të AKEP)

#### 10. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

Kandidatet do të vlerësohen nga **Komiteti i Pranimit për Levizje Paralele (KPLP) i ngritur në AKEP**, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është **100 pikë**, të cilat ndahen përkatësisht:

- a. **40 pikë** për dokumentacionin e dorëzuar i ndarë: 20 pikë për përvojen, 10 pikë për trajnime dhe kualifikime në fushën përkatese, si dhe 10 pike për certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë, në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer.
- b. **60 pikë** për intervistën e strukturuar me gojë;

Komiteti, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikët maksimale, për t'u emëruar në pozicionin "**Inspektor i Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike**".

Në rast se dalin fitues më shumë se një kandidat, me pikë të barabarta, zbatohen parashikimet e pikes 23, Kreu II të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015 "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese".

11. Lista e fituesve me mbi 70 pikë (mbi70%) do të shpallet në datën **29.05.2018**.

12. **Njoftimi do të bëhet**: në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" dhe në faqen zyrtare të AKEP në datën **30.05.2018**.

Shpallja është e hapur për të gjithë nëpunësit civil të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

*Vetëm në rast se pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezultojnë se janë ende vakante, ato janë të vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.*

## **II. NGRITJE NË DETYRË**

1. Shpallje për ngritje në detyre për plotësimin e vëndit të lirë të punës në AKEP:

Në zbatim të Kreut V të Ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nepunësin civil”, i ndryshuar si dhe Kreut III të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) shpall procedurat e Ngritjes në Detyrë :

### **“Inspektor i Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”**

#### **Drejtoria e monitorimit, kontrollit dhe inspektiveve**

Kategoria e pagës III-a

2. Përshkrimi i përgjithshëm i punës (detyrat kryesore) për këtë pozicion janë:

#### **- MISIONI :**

Siguron mbështetje për zbatimin me profesionalizëm dhe përgjegjësi të detyrave funksionale të njësisë organizative lidhur me kontrollin dhe inspektimin e veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet/e të autorizuar nga AKEP sipas legjislacionit material të fushës së komunikimeve elektronike.

#### **- QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I POZICIONIT TË PUNËS:**

Inspektori i Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike përgjigjet përpara Përgjegjësit të Sektorit të Kontrollit dhe Inspektimit për zbatimin me profesionalizëm dhe përgjegjësi të detyrave funksionale lidhur me kontrollin dhe inspektimin e veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet/e të autorizuar nga AKEP sipas legjislacionit material të fushës së komunikimeve elektronike, me qëllimi përmbrushjen e misionit të drejtorisë, objektivave si dhe detyrimeve ligjore dhe rregullatore.

#### **- DETYRAT KRYESORE:**

Inspektori i Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike, siguron që:

1. T'i jepet mbështetje eprorit direkt për administrimin dhe mbarëvajtjen e procesit të kontrollit dhe inspektimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet/e të autorizuar nga AKEP mbi bazën e legjislacionit material të fushës së komunikimeve elektronike, sipas metodologjisë dhe akteve rregullatore të nxjerra nga AKEP për këtë qëllim.
2. Të japi mbështetje për kryerjen e analizave të riskut dhe zbatimin e rekomandimeve si dhe masave administrative të vendosura për subjektet e kontrolluara dhe inspektuara.
3. Të japi mbështetje që raportimi dhe dhënia e informacionit periodik dhe të vazhdueshëm për punën dhe përbushjen e detyrave në kuadër të veprimtarisë së njësisë organizative, të kryhet në afat dhe sipas procedurës së përcaktuar në aktet e nxjerra nga Titullari për këtë qëllim.
4. Të japi mbështetje dhe sigurojë që rekomandimet dhe masat e vendosura për shkeljet dhe kundërvajtjet administrative të provuara, të jalin rezultate të matshme në drejtim të disiplinimit të ushtrimit të veprimtarisë nga subjektet e autorizuara, në përputhje me legjislacionin dhe kuadrin rregulator në fuqi, në mënyrë të veçantë në mbrojtjen dhe garantimin e zbatimit të të drejtave ligjore të përdoruesve.
5. Ti japi mbështetje eprorit direkt që bashkëpunimi me Inspektoriatin Qendror dhe organet e tjera ligjzbatuese të fushës , të jetë i përhershëm, i vazhdueshëm dhe në konformitet me ligjin.
6. Bashkepunon ngushtesisht me Sektoret Rajonale te Monitorimit dhe Inspektimit, per shkembimin e informacionit dhe perpunimin e tij.
7. Inspekton sipermarresit/subjektet bazuar ne planin e veprimit dhe dokumentave rregullatore ne fuqi;
8. Pergatit aktet e inspektimit dhe ndjek ne vashdimesi zbatimin e rekomandimeve/ propozimeve të shoqëruara me afate, për rregullimin e shkeljes/ve se konstatuar nga grupi i inspektimit.
9. Pergatit procedurat per zbatimine e detyrave per te cilat eshte marre vendim nga instanca perkatese, ben komente dhe jep rekomandime per ate pjese te korespondences se AKEP qe i delegohet dhe ka te beje me inspektimin.
10. Organizon dhe zbaton me drejtoritë e institucionit, kryerjen e veprimtarisë së inspektimit të planifikuar apo rastesor;
11. Zbaton procedurat administrative dhe organizative për planifikimin dhe kryerjen e inspektiveve në sektorin e komunikimeve elektronike;

12. Propozon dhe pergatit planet e inspektimit
13. Bashkepunon ngushtesisht me Zyrat Rajonale te Monitorimit dhe Inspektimit, per shkembinin e informacionit dhe perpunimin e tij.
14. Inspektion sipermarresit/subjektet e komunikimeve elektronike, bazuar ne planin e veprimit dhe dokumentave rregullatore ne fuqi;
15. Pergatit aktet e inspektimit dhe ndjek ne vashdimesi zbatimin e rekomandimeve/ propozimeve te shoqeraura me afate, per rregullimin e shkeljes/ve se konstatuar nga grupi i inspektimit.
16. Mer pjesa ne procesin e bllokimit te pajisjeve kur identifikohen subjekte te cilat zhvillojne veprimtari ne fushen e komunikimeve elektronike, te paautorizuar nga AKEP
17. Mer pjesa ne procesin e inspektimeve ne sektorin postar dhe regjistrareve te domain.al kur i kerkohet.
18. Pergatit procedurat per zbatimine e detyrate per te cilat eshte marre vendim nga instanca perkatese, ben komente dhe jep rekomandime per ate pjesa te korespondences se AKEP qe i delegohet dhe ka te beje me inspektimin.

### **3. Kërkesat e veçanta për këtë vend pune janë :**

**Arsimi :** Të zotëroje diplomë “Master Shkencor” në Shkencat e Inxhinierise Elektronike, Shkencat e Telekomunikacionit/ Shkencat Juridike.

**Përvoja :** Të ketë eksperiencë profesionale në fushën e komunikimeve elektronike, telekomunikacionit, juridike dhe administrative.

**Të tjera :** Të detyrueshme,

- Njohuri të mira në fushën e komunikimeve elektronike.
- Njohuri shumë të mira praktike në përdorimin e kompjuterit dhe të programeve aplikative të administrimit të dhënavës dhe aftësi për të përpunuar të dhëna teknike.
- Njohja e gjuhës angleze e certifikuar në nivel profesional. Çdo gjuhë e huaj tjetër përbën avantazh.
- Aftësi analitike dhe krijuese për zgjidhjen e situatave komplekse.
- Njohuri dhe interes i vazhdueshëm për të qenë në korrent të parimeve dhe praktikave më të mira për kontrollin dhe inspektimin në vendet e BE dhe më gjërë.
- Njohuri dhe interes i vazhdueshëm për të qenë i informuar vazhdimisht me vendimet e nxjera nga Këshilli Drejtues, organizatat ndërkombëare të fushës ku Republika e Shqipërisë/AKEP aderon të cilët janë gjithnjë orientues në punë.

- Aftësi vet-motivuese për të punuar i pavaruar brenda afateve kohore të ngushta në një mjedis pune intensiv, me qëllim përgatitjen e dokumenteve rregullatore.
- Aftësi vet-organizuese, dhe aftësi krijuese për të dhënë sugjerime dhe propozime të dobishme për ecurinë e punës.
- Aftësi shumë të mira për të relatuar me shkrim dhe me gojë në nivelet më të larta drejtuese.
- Të ketë cilësitë e nevojëshme për të punuar në grup.

**4. Kushtet minimale** që duhet të plotësojnë kandidatët, për këtë procedure, janë:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;
- ç- Të plotësojë kushtet e tjera të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, për klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil;
- d- Të përbushë kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

**5. Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e Protokollit të AKEP, dokumentet e dosjes së tij personale:**

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
- Jetëshkrimi i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende -vakante/udhëzime-dokumenta/219-udhëzime-dokumenta>.
- Nje numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID) ose Pashaportës.
- Fotokopje të diplomave.
- Fotokopje të listës se notave.
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vertetojnë eksperiencën në punë).
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.
- Aktin e emëritit si nëpunës civil.
- Vërtetimin nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi
- Vertetimin e gjendjes shëndetësore.
- Vertetimin e gjendjes gjyqësore.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.
- Formulari i vetëdeklarimit për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike sipas linkut  
<http://www.dap.gov.al/legislacioni/udhezime-manuale/104-formularin-i-vetedeklarimit-per-garantimin-e-integritetit-te-personave-qe-zgidhen-emerothen-ose-ushtrojne-funksione-publike->

6. Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në zyrën e Protokollit, të Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), Rr. Reshit Çollaku, brenda datës **22.05.2018**.

**7. Rezultatet për verifikimin paraprak** të kandidateve që përbushin kushtet dhe kërkesat e vecanta, të përcaktuara në shpalljen në konkurim do të dalin në datë **01.06.2018** nëpërmjet shpalljes së listës emërore të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Institucionit të AKEP. Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse, brenda 5 ditëve kalendarike nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

**8. Konkurimi**

- **Testimi me shkrim** do të zhvillohet në ambientet e AKEP (salla e mbledhjeve), Rr.Reshit Çollaku, në datën **12.06.2018** ora **10:30**.
- **Intervista me gojë** do të zhvillohet në ambientet e AKEP (salla e mbledhjeve), Rr.Reshit Çollaku, në datën **12.06.2018** ora **13:00**.

**9. Fusha kryesore mbi të cilën bazohet konkurimi:**

- Kushtetuta e Republikës se Shqiperise;
- Kodi i Punes
- Kushtetuta e Republikës se Shqiperise;
- Kodi i Punes
- Kodi i Procedurave Administrative
- Kodi Civil
- Ligjin nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”i ndryshuar dhe akteve nënligjore të tij;
- Ligjin nr.9131, datë 08.09.2003 “*Për rregullat e etikës në administratën publike*”;
- Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014, “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, i ndryshuar.
- Ligjin 119/2014 “*Për të drejten e informimit*”
- Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*” i ndryshuar
- Ligjin Nr. 9049, datë 10.04.2003 ”*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë*” i ndryshuar
- Ligjin nr. 9918, datë 19.08.2008 “*Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, (<http://www.akep.al/legislacioni/ligje>)
- Ligjin Nr. 46/2015 “*Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë*” (<http://www.akep.al/legislacioni/ligje>)

- RREGULLORE  
<https://akep.al/legislacioni/rregullore>  
<https://akep.al/sherbim-postar/rregullore>
- <http://www.akep.al/legislacioni> (Ligj, VKM, Rregullore, në faqen zyrtare të AKEP)

#### 10. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

Kandidatet do të vlerësohen nga **Komiteti i Pranimit për Ngritjes në Detyre në AKEP**, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar, vlerësimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është **100 pikë**, të cilat ndahen përkatësisht:

- a. **20** pikë për dokumentacionin e dorëzuar
- b. **40** pikë për intervistën e strukturuar me gojë;
- c. **40** pikë për vlerësimin me shkrim.

Komiteti, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikët maksimale, për t'u emëruar në pozicionin **“Inspektor i Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”**.

Kandidati fitues, është ai që renditet i pari nga kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70 % të pikëve). Në rastet e kandidatëve me pikë të barabarta, zbatohen parashikimet e pikes 23, Kreu II të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015 “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”.

11. Lista e fituesve me mbi 70 pikë (mbi70%) do të shpallet në datën **13.06.2018**.

12. **Njoftimi do të bëhet**: në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të AKEP në datën **14.06.2018**.